



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HAS

Has më 23.09.2026

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**“Blerje Dru Zjarri“**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

- 03413000-8 - Dru zjarri

**VLERA E FONDIT LIMIT: 3,819,018 (Tre milion e teteqind e nentembedhjetë mijë e tetembedhjetë) Lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Has ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar). **Rekomandimi Nr. 1797/1 Prot., dt. 10.03.2022 ”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, pune, shërbime.**

**2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

Te plotesoj kriteret e pergjithshme sipas shtojces 9. Objekti i prokurimit te jete i parashikuar ne ekstraktin e operatorit ekonomik.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, i ndryshuar, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

(Shënim: *përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit*).

## **2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

1. Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore për tre vitet 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera mesatare e xhiros minimale, ne te pakten nje vit te periudhes se kerkuar te jete jo me e vogel se 40 % të vlerës së perlllogaritur të kontratës
2. Kopje e vertetuar te bilancit te 3 viteve te fundit 2023, 2024 dhe 2025 te paraqitur prane Administrates Tatimore te konfirmuar nga ky autoritet. *ku te paktën në dy bilance te njepasnjeshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit*".

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Nisur nga vlera e xhiros vjetore që deklaron një subjekt ekonomik, varet kapaciteti financiar i tij i cili perket ne kapacitet per te realizuar kontraten objekt prokurimi

---

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar\ Ligji Nr.9920, datë 19.5.2008 për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë i ndryshuar. (Shënim: *citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore*).

Neni 29, Cdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

**Rekomandimi Nr. 1797/1 Prot., dt. 10.03.2022 "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, pune, shërbime.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.25/2018 ”Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

### **2.3 Për kapacitetin teknik:**

**3** Dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të vogël** se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a) Autoriteti Kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, kontrata furnizimi ose/dhe fatura tatimore të shitjes, (faturat duhet të jene të deklaruara ne organet tatimore) ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, *te plotesuara sipas legjislacionit ne fuqi dhe te deklaruar ne organet tatimore..”*

2.Liçensa profesionale lidhur me mallrat objekt i kontratës

### **3.Te pakten nje makine transportuese, kamion.**

Per te deshmuar kete, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentat e mëposhtme:

- Per mjetet që shenohen ne regjistra publike, nese jane ne pronesi, duhet te paraqiten dokumenta që vertetojne regjistrimin e mjetit leje qarkullimi, çertifikata e kontrollit teknik, polica e sigurimit vjetor.

- Per mjetet që shenohen ne regjistrat publik, nese jane me qera, duhet te paraqiten dokumenta që vertetojne regjistrimin e mjetit leje qarkullimi, çertifikata e kontrollit teknik, polica e sigurimit vjetor, si dhe kontrata perkatese e qerases e vlefshme gjate zbatimit te kontrates.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Nëse operatori ekonomik ka realizuar me sukses një kontratë e cila i pergjegjet 20% të vlerës së fondit limit atëherë ai ka kapacitet për të realizuar kontratën në fjalë. Përcaktimi i kësaj vlere është bërë në përputhje me aktet ligjore dhe nenligjore. Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entitet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

---

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

- Drutë duhet të dorëzohen në çdo objekt (**zyra, shkolla, kopshte dhe çerdhe**) pranë Njësive Administrative të Bashkisë Has, dhe të sistemohen me qëllim matjen e tyre.
- Drutë duhet të jenë të stivosura në objekt dhe do të merren në dorëzim sipas grafikut të nënshkruar midis operatorit ekonomik dhe AK-se, brenda orarit zyrtar të punës dhe jo në ditë pushimi apo festash zyrtare.
- Furnizimi do të bëhet nga kontraktuesi me automjetin e tij nga pika e furnizimit deri në destinacion sipas grafikut të levrimit mallit.
- Në rast se malli objekt prokurimi (dru zjarri) nuk plotëson kërkesat dhe standartet teknike, nuk do të merret në dorëzim.
- Malli do të merret në dorëzim sipas afatit të përcaktuar në DST
- Malli do të dorëzohet brenda orarit zyrtar të punës dhe jo në ditë pushimi apo festash zyrtare.
- Furnizimi do të bëhet nga kontraktuesi me automjetin e tij nga pika e furnizimit deri në destinacion. Në rast se malli objekt prokurimi, nuk plotëson kërkesat dhe standartet teknike, nuk do të merret në dorëzim.
- Për detaje me të veçanta do të përcaktohen në kontratën objekt prokurimi me operatorin ekonomik (OE) të shpallur fitues.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizojnë produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin*

*e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*